

Bajram Selmani, PhD¹

UDC:
373.3.016

**KURIKULI I FSHEHTË-JOFORMAL - KUPTIMI, PËRMBAJTJA
DHE RËNDËSIA E TIJ NË REALIZIMIN E QËLLIMEVE TË
KURIKULIT FORMAL NË SHKOLLËN FILLORE**

**СКРИЕНИОТ-НЕФОРМАЛЕН КУРИКУЛУМ – ПОИМ,
СОДРЖИНА И НЕГОВО ЗНАЧЕЊЕ ВРЗ РЕАЛИЗАЦИЈА НА
ЦЕЛИТЕ НА ФОРМАЛНИОТ КУРИКУЛУМ ВО
ОСНОВНОТО УЧИЛИШТЕ**

**THE HIDDEN-INFORMAL CURRICULUM - NOTION, CONTENT
AND ITS IMPORTANCE IN ACHIEVING THE GOALS OF THE
FORMAL CURRICULUM IN PRIMARY SCHOOL**

Abstract

Informal-hidden curriculum in school is an important segment for implementation and progress of the teaching process especially the realization of the objectives as an essential component of the curriculum.

The informal curriculum comprises and manifests through the interactive relationship of the holders and users of educational value in the school, according to the various segments in action.

The importance and presence of segments of the hidden curriculum in schools is a compelling need because they strongly affect

¹ Universiteti i Tetovës

the overall formation of the individuality of student's with mental, emotional and intellectual values.

Basic concepts: (informal - hidden curriculum, soft reality, hard reality, plan and program).

Kurikuli i fshehtë-joformal kuptimi dhe përmbajtja

Kurikuli i fshehtë është tërësi e segmenteve, situatave, veprimeve, akteve, që në mënyrë joformale ndikojnë shumë në realizimin e plotë dhe të suksesshëm të planit dhe programit mësimorë të shkruar – gjegjësisht kurikuli i fshehtë përfshin çdo veprim që mundet të ndikojë në edukimin, formimin dhe arsimimin e nxënësit si subjekt i cili është në formim, i cili paraprakisht nuk mundet të parashikohet dhe të planifikohet. Kurikuli joformal qëndron në ambientin i cili e rrethon nxënësin dhe ndaj të cilit reflektohet nëpërmjet formave të ndryshme vepruese gjatë kohës së qëndrimit të fëmijës-nxënësit në jetën shkollore që manifestohen nëpërmjet veprimeve, vlerave, kërkesave, pritjeve të paparashikuara të pashkruara dhe shumë shpesh për ata askush nuk na tregon, por të cilat duhet t'i pranojmë dhe praktikojmë në jetën tonë. Sipas E. Dirhemit ¹ “gjatë procesit të mësimin shumëçka mësohet edhe nga veprime apo përmbajtje të paplanifikuara dhe të paprogramuara, në shkollë mësohet më shumë se çka është planifikuar dhe shkruar nëpër libra”. Kurse sipas Filip Xheksoni i cili së pari e përdor kuptimin kurikul i fshehur në veprën e tij: “Jeta në klasë” (Life in Classrooms, 1968)² me të cilën shprehje (kurikul i fshehur) nënkuptohet; nevoja për mësimin edhe të efekteve joformale të cilat janë të pranishme në shkollë të cilat janë shumë të rëndësishme.

Filip Xheksoni me shprehjen kurikul i fshehur në shkollë pasqyroi 3 rregullat (3RS - 3 ruttin skil) e pa përshkruara që manifestohen në shkollë të cilët janë: angazhimin e nxënësit që të formojë strategji me qëllim të aftësohet të ballafaqohet me detyrimin ose mësim për jetë demokratike, jashtë programit formal-oficial.

Zhan Martin (1976)³ në artikullin “Çka duhet të bëjmë me programin e fshehur” thekson se: “Programi e fshehur mundet të jetë e pranishëm - shprehet në strukturën sociale në shkollë si : në autoritetin e arsimtarit, në rregullat e sjelljes në mes arsimtarit dhe nxënësit, në aktivitetet e standardizuara të mësimin, në gjuhën e të shprehurit gjatë

komunikimit, në tekstet shkollë-librat, në sistemin e përcjelljes së përparimit të nxënësve, në përparësitë në planin mësimor”.

Sipas Blakswell, (2000)⁴, - programi i fshehtë është koncept me të cilin shprehet përshkrimi i veprimeve që shumë herë nuk janë të artikuluar dhe të pa pranueshme të cilat nxënësve u jepen në shkollë.

Sipas Horn (2003)⁵, - programi i fshehur është tërësi e gjërë e cila i përfshinë të gjitha dituritë e qëllimshme dhe të paqëllimshme, vlerat dhe bindjet e formuara gjatë procesit të mësimin në klasë – shkollë...

Në pasqyrimin e tipologjisë së kurikulave nga Longstrit dhe Shane, (1993)⁶, - programin e fshehtë e definojnë si lloj i mësimin që përfitohet nga vet natyra e dizajnit të një shkolle publike si dhe nga shprehja, sjelljes dhe shprehive të arsimtarëve dhe administruesve në shkollë. Kurikuli i fshehtë përbëhet nga të gjitha veprimet dhe vlerat e dukshme me ndikim dhe në të gjitha vlerat e ndryshueshme që e përcjellin organizimin, kriteret e pranishme, politikën e trajnimit dhe përparimit të subjekteve të kyçur në shkollë, konceptcionin e politikës arsimore, rregulloren së aprovuar të përshtatshme osë të papërshtatshme.

Kurikuli i fshehtë qëndron në mësimin-përvetësimin dhe formimin e qëndrimeve, normave, bindjeve, vlerave, supozimeve etj., që shpeshherë shprehen në formë të rregullave, ritualeve apo dispozitave dhe vlerësimi se segmentet përbërëse të kurikulit të fshehur-joformal janë pozitive apo negative varet nga qëndrimet vlerësuese të individit i cili ballafaqohet me ata ose i pranon ata vlera. Gjegjësisht kurikuli i fshehtë ka të bëjë me vlerat e qëllimshme apo të paqëllimshme që realizohen në përditshmërinë jetësore në shkollë dhe jashtë saj dhe në aktivitetet plotësuese të cilat realizohen gjat qëndrimit të fëmijut-nxënësit në shkollë.

1. Kentli, F. D. 2009. COMPARISON OF HIDDEN CURRICULUM THEORIES, Department of Education Science, European Journal of Educational Studies 1-2, University of Hamburg, 20146, Hamburg, Germany, p.

2. Ibid.

3. <http://wik.ed.uiuc.edu/a>. Hidden Curriculum, Description of the term Hidden Curriculum, 05:18, 22 July 2008, by Andrew Trost. Based on work by Tony Hursh, Jakob and Craig Johnson and WikEd users Etoney and Rbritez.

4. Ibid

5. Ibid

6. Longstreet, W. S. and Shane, H.G, 1993, Curriculum for a new millennium, Description of the term

Hidden Curriculum Boston: Allyn and Bacon, 26, Boston, London. p. 3.

Rëndësia dhe roli e kurikulit të fshehtë-joformal në realizmin e qëllimeve të kurikulit formal në shkollën fillore

Kurikuli i fshehtë-joformal përfshinë segmente jetësore me të cilat ballafaqohet drejtëpërdrejt fëmija në përditshmërinë jetësore, gjatë realizimit të obligimeve apo detyrimeve të cilat duhet të realizohen sipas programit oficial-formal në shkollë apo sipas trajtimeve teorike nga më shumë autorë kurikuli i fshehtë ka të bëjë me përvetësimin e diturive, vlerave, shprehive dhe shkathtësive të paartikuluara, ndonjëherë edhe të paqëllimshme, vlera të cilat mundet të jenë pjesë e procesit të mësimin në shkollë-klasë e pasqyruar në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi dhe në aktivitete e veprime jashtëmësimore.

Çdo aktivitet me të cilin merren fëmijët-nxënësit ndikon që diçka të mësohet edhe pse aktivitetet e tilla nuk janë të planifikuara dhe të organizuara me qëllim dhe të njëjtat shpesh nuk janë përvojë pozitive. Aktet, normat, vlerat... e transmetuara nëpërmjet kurikulit joformal-të fshehtë merren nga burime të ndryshme dhe në forma të ndryshme gjatë gjithë jetës së fëmijës si nxënës.

Burimet dhe mundësitë të cilat ofrojnë ndikim në zhvillimin dhe formimin e personalitetit të nxënësit si qenie në zhvillim janë të shumta dhe të pa kufizuara, në këtë trajtim teorik të këtij kërkimi do të përqendrohemi në disa segmente të kurikulit joformal-të fshehtë të cilat drejtpërsëdrejti kanë ndikim të shprehur në realizimin e plotë të qëllimeve të kurikulit formal nacional, me qëllim të gjetjes së përgjigjes për tezën e parashtruar: Ndikimi i kurikulit të fshehtë-joformal në realizmin e qëllimeve të kurikulit nacional në shkollën fillore; - Niveli i rëndësisë dhe niveli i pranisë së segmenteve nga kurikuli joformal-të fshehtë në praktikën pedagogjike në shkollën fillore.

Sipas trajtimeve teorike të kurikulit të fshehtë-joformal nga autorë të ndryshëm si: e E. Dirkem, 1925, Ph.. Xhekson ,1968, H. Giroux ,1981, Tarner T,1983, Bullivant,1987, Linç ,1989, Dejvis,1990, Voker ,1990, Cornbleth ,1991, Portelli,1993, Whitty,1995, Kaming, 1996 dhe të tjerëve konstatohet se;

- Kurikuli joformal është proces dhe rezultat i të mësuarit.
- Kurikuli joformal shpesh përdoret për legalizimin formimit apo ruajtjen e raporteve sociale të kategorive dominuese me qëllim të forcimit të rendit dhe vlerave shoqërore ekzistuese.
- Kurikuli joformal-i fshehtë mundet të shërbejë për plotësimin e propozim iniciativave që më pas ai propozim-iniciativë të merr karakter formal dhe të inkorporohet në strukturën e kurikullit formal dhe të realizohet si pjesë sistimore oficiale e kurikullit.
- Arsimitarët, nxënësit, prindërit dhe administratorët shpesh nuk i çmojnë njëjtë lëndët mësimore të plan-programit të shkollës dhe si rrjedhojë nxënësit nuk kanë qasje të njëjtë ndaj të gjitha lëndëve mësimore, është segment i kurikullit joformal.
- Shpesh, në shkollë më shumë mbështeten dhe vlerësohen aftësitë teorike të nxënësve përkundër aftësive praktike të cilat në një mënyrë apo tjetër marginalizohen ose nuk merren parasysh.
- Shpesh në praktikën shkollore ka sjellje ndryshe ndaj individëve apo grupe të fëmijëve-nxënësve me ndryshime fizike, intelektuale, sociale, gjinore, etnike dhe ndryshim etj.
- Konkurrenca individuale shpesh mungon ose nuk pranohet si vlerë e individëve për arsye të ndryshme, joobjektive.
- Koha formale, mjetet dhe materialet e disponueshme, programet e mësimit, lëndët e mësimit dhe librat themelorë merren si të vetmet burime legjitime për të mësuar dhe mësim.
- Shpesh mungon korektësia, objektiviteti dhe transparenca gjatë kontrollimit, vlerësimit dhe notimit të të arriturave të nxënësve.
- Prania e qëndrimit jo të drejtë e raportit të shkollës ndaj ligjeve, adeteve, sjelljeve, të individëve apo grupeve të nxënësve të ndryshëm të cilët janë pakicë ndaj shumicës.
- Qasje e ndryshe, jokonsekuente e arsimtarit gjatë interpretimit të kurikullit oficial-formal dhe kurikullit të fshehtë-joformal, në rastin e parë është në qendër të vëmendjes dhe me përkushtim maksimal, ndërsa në interpretimin dhe mbështetjen e kurikullit të fshehtë-joformal arsimtari është më pak i përkushtuar dhe secili arsimtar ka qasje individuale apo e trajton sipas vullnetit të tij kurikullin e fshehtë-joformal.
- Tjetërsimi i fëmijës-nxënësit në përditshmërinë shkollore është shumë e pranishme. Shpesh fëmija me qëllim që t'u ik sanksioneve duhet të mësohet se kur të merr lejen që të flet, me kë të flet, ku dhe kur duhet të ulet, arsimtarit çdoherë t'i tregojë dituri të sakta nga mësimi, të përulet apo të pajtohet me notën apo ndonjë vlerësim tjetër që ia bën

arsimtari përndryshe nëse kundërshton apo nuk i pranon mënyrat e ofruara nga arsimtari nuk do ta fitojë vlerësimin e apo statusin e merituar.

- Shkolla nuk është vend vetëm për përvetësimin e diturive, shprehive dhe shkathtësive, por nxënësit janë pjesëmarrës aktiv në përvetësimin e diturive (në arenën e konflikteve, garave dhe kompromisit në klasë-shkollë (1982)¹.


Shikuar në aspektin hapsinor kurikuli i fshehur shtrihet në hapësirë shumë herë më të gjerë se kurikuli formal, referuar në Konkluzionet e Konferencës së 18 nacionale të këshillit mësimor nacional në Angli të mbajtur në muajin mars 1999 qëndron konstatimi si vijon: “Flitet shumë për qëllimet, përmbajtjet, lëndët, orarin, kurikulat, standardet dhe teknologjitë e mësimin, të cilat janë çështje të rëndësishme, por këtë janë në pjesën e dukshme në sipërfaqe (shprehur në mënyrë objektive) mbi ujë, në *majë të trupit të akullit* të cilën mundemi ta perceptojmë - shohim, apo është pjesë për të cilën flitet dhe ai *është pjesa e hapur e dukshme e kurikulit - programit mësimor*. Por ajo për të cilën mendohet se nuk është shumë e rëndësishme, ai është kurikuli – programi i fshehtë-joformal i cili qëndron në pjesën për të cilin arsimtarët, nxënësit, prindërit, administratorët mendojnë, besojnë, kanë qëndrim, presin... ai është pjesa (shprehur në mënyrë objektive) *nënujore e trupit të akullit e programit, ajo është pjesa e fshehtë e programit mësimor*, pjesa më e madhe e së cilit është e panjohur për të cilin pak flitet dhe shpesh edhe anashkalohet ose nënvlerësohet”.²

Në mënyrë të ilustruar ky vështrim është paraqitur si një trup i ngrirë i cili qëndron në ujë.

a) Pjesa e dukshme e akullit, mbi ujë paraqet programin mësimor-kurikulin e hapur apo formal.

b) Pjesa e padukshme e akullit, nën ujë e paraqet pjesën e padukshme të programit – kurikulin e fshehtë apo joformal.

a) “overt” curriculum



b) “covert” curriculum

Pavao Brajšha (1995) pjesën e formale formale të kurikulit e quan realiteti i fortë. i cili paraqet pjesën e dukshme të kurikulit apo pjesën formale të veprimtarisë së shkollës. Ndërsa kurikulin e fshehtë-joformal e quan *realitet i butë*, i cili përfshinë vlera, rregulla, principe dhe mënyra të udhëheqjes, rregulla të lojës, besim dhe mendim për veten dhe të tjerët, pritje reciproke të cilat kanë ndikim të qenësishëm në udhëheqjen e tjerëve. Këto rregulla apo mënyra të shprehjes i hasim si rregulla të shkruara apo të pashkruara, gjatë komunikimit të hapur ose të fshehur-jo verbal apo vetëm nëpërmjet komunikimit verbal. Forma të shprehjes së realitetit të butë janë edhe motoja, anekdota, lojëra, adete, simbole, mënyra e të folurit dhe të udhëheqjes. Kjo tërësi e vlerave të internalizuara të sjelljeve të *realitetit të butë* të të punësuarit dhe të nxënësit formojnë mënyra të paraqitjes, shprehjes dhe bindjeve. Ajo është pjesa e paplanifikuar e brendshme (frymës) së shkollës, e cila e shty në mënyrë të tërthortë ndërtimin e planit të zhvillimit dhe pamjen e shkollës së ardhme ajo qëndron në kokën e arsimit dhe mundet të quhet skenar i shkollës, që përmbledh në vete veprime shumë më të mëdha në raport me realitetin e fortë gjegjësisht të pjesës së dukshme të shkollës apo kurikulit formal”³ Dhe pasqyra e skicuar duket si vijon:

Realiteti i fortë

Pjesa sipërfaqësore e trupit të akullt që lundron në det

Pjesa e dukshme e veprimtarisë së shkollës

(Kurikuli formal)

Realiteti i butë

Pjesa nënujore e bregut të akullt

Pjesa e fshehtë e veprimtarisë shkollore

(Kurikuli joformal)

Njerëz, dashuri, motivim, kreativitet, stil të udhëheqjes, punën ekipore, komunikim ndërveprues, raportet reciproke, besim reciprok, vizion, qëllim, parafytyrim, lojalitet, kuptim

Kurikuli është përfshirje e tërësishme e veprimtarive me ndikim në shkollë në të cilin projektohen të gjitha segmentet që mundet të kyçen në procesin e të mësuarit në një institucion arsimor dhe edukativ:

- rezultatet e pritura nga mësimi dhe të mësuarit (qëllimet),
- përmbajtjet nëpërmjet të të cilave realizohen detyrat për aritjen e qëllimeve dshë objektivave të parashtruara,
- strategjitë efikase për sigurim të parakushteve për sukses
- teknologjitë e përshtatshme
- mjedis të përshtatshëm për punë mësimore
- përcjellje, kontrollim dhe evaluim të të arriturave,

Në praktikën pedagogjike pranë kurikutit oficial-formal drejtpërdrejt apo tërthorazi me ndikim konstruktiv është inkorporimi edhe i kurikutit të fshehtë-joformal në përditshmërinë shkollore.

Në teoritë e kurikulave trajtohet kuptimi, roli dhe rëndësia e kurikutit joformal si tërësi e veprimeve nga të cilat nxënësi mëson në shkollë (veprime të cilat mund të mos jenë të natyrës njohëse, afektive, sociale, morale apo psikomototrike që sipas taksonomisë së Blumit mundet të parashikohen) por të njëjtat nuk mundet tërësisht të parashikohen gjatë planifikimit oficial-formal me të cilin ndoshta ndonjë veprim joformal është edhe në kundërshtim për ndonjë segment veprimi, por mund të jetë me ndikim qenësor dhe si segment i kurikutit joformal të bëhet pjesë përbërëse e kurikutit formal.

Shpesh pjesët përbërëse të kurikutit të fshehtë-joformal janë pozitive ose negative varësisht nga qëndrimet vlerësuese - personit i cili ballafaqohet më ata segmente të kurikutit të fshehtë – joformal. Pra

kurikuli i fshehur qëndron në tërësinë e vlerave që përvetësohen nga fëmija – nxënësi pa u planifikuar paraprakisht, në përditshmërinë shkollore në klasë, jashtë klasës dhe shkollës dhe në aktivitetet tjera jashtëmësimore.

- Kujdesi dhe vëmendja jo i njëjtë ndaj secilit nxënës në shkollë pa marr parasysh çfarëdo lloj ndryshimi në mes tyre

- Mos respektimi dhe mos pranimi i konkurrencës konstruktive individuale

- Kufizimi i kohës formale për shërbime në shkollë

- Mosrespektimi dhe mospranimi i vlerave joformale tradicionale të individëve apo grupi të nxënësve

- Tjetërsimi i nxënësit si individ.

- Mospranimi i mendimit jo ë plotë të nxënësit

- Mosrespektimi i kundërshtimit të arsyeshëm nga nxënësi

- Ushtrimi i dëgjueshmërisë autoritare

- Pakujdesia ndaj nxënësit të tërhequr

- Pakujdesia ndaj nxënësit asocial apo delikuent

- Pakujdesia ndaj punëve jo formale të nxënësit në shkollë

- Moskujdesi ndaj frymës kolektive në klasë

- Tjetërsimi i lëndëve mësimore si: gjuhësore, shkencore, të shkathtësive

- Përparim dhe vlerësimi i individëve apo grupe të nxënësve sipas nivelit arsimor, pozicionit politik apo elitare të prindërve

- Aktivitetet në shkollë me qëllim të legalizimit të vlerave të shtresës sociale dominuese në mjedis me qëllim të ruajtjes së pozitës ushtrimit të politikës

- Plotësimin e propozim iniciativës së asociacioneve, provajderëve bartës të projekteve për kyçje në shkollë

Në një kërkim të realizuar në lidhje me vërtetimin e tezës: roli i kurikulit të fshehtë – joformal në realizimin e qëllimeve të kurikulit formal në shkollën fillore në R. e Maqedonisë u veçuan disa segmente të kurikulit joformal të cilat janë në mbështetje të realizimit të qëllimeve si komponentë themelore për realizimin efikas të kurikulit formal në shkollë dhe sipas analogjisë u grupuan në përbërje të tezave për punë si:

1. Raporti i arsimtarit ndaj nxënësit të gjinisë së ndryshme, me sukses të ndryshëm dhe me status intelektual dhe problemor.

2. Formimi i vlerave edukative - komunikimi interaktiv i ndër-sjellë, formimi i qëndrimit. Sjelljes, bindjes, ndjenjës së përkatësisë, dhe mendimit ndryshe.

3. Transparenca në punën - ekspozimi i punimeve, mirënjohjeve, falënderimeve donacioneve kolektive për nxënësit dhe rregullorja për sjellje e aprovuar nga nxënësit në hapësirat frekuentuara në shkollë.

4. Humanizmi i raporteve inter dhe intrapersonale – sigurisë, sigurimi i rendit, disiplinës, sinergjisë, raportit të drejt ndaj secilit individ, mirëkuptimi - mirëqenia shumetnike, ambienti i rregulluar shkollor.

5. Autoriteti dhe takti pedagogjik i arsimtarit - praktikimi dhe respektimi i autoritetit dhe taktit pedagogjik dhe saktësia në veprim.

6. Stimulimi, motivimi dhe evaluimi i nxënësve. Notimi si proces diagnostik, formativ dhe vlerësues për plotësimin e nevojës administrative, informative dhe nxitëse.

7. Aktivitetet jashtë mësimore dhe bashkëpunimi me prindërit - ndikimi efikas i kohës së caktuar formale për punë, ofrim të shërbimit nga personalit arsimore ndaj nxënësve dhe bashkëpunimi me prindërit.

8. Kodi i sjelljes dhe manifestimet në shkollë. Ndikimi formal i kodeksit të sjelljes të sjellë nga nxënësit, biseda e lirë - joformale me nxënësit në klasë, organizimi dhe realizimi i manifestimeve shkollore.

9. Takti pedagogjik. Prania e vlerësimit të drejtë dhe transparent të punës së nxënësit, edukimi dhe kultivimi i vetëbesimit, identifikimi nxënësve të mbyllur apo të tërhequr në vete dhe ofrimi i ndihmës për dalje nga ajo gjendje, mbështetja e nxënësve nga arsimtari, biseda formale me nxënësit dhe uniteti në veprimin pedagogjik i arsimtarëve në shkollë.

Nga analiza statistikore dhe interpretimi teorik i të dhënave të grumbulluara nëpërmjet pyetësorit nga subjektet: arsimtarë, bashkëpunëtorë profesional dhe nxënës në shkollat fillore, të zgjedhura me qëllim, për konstatimin e nivelit të rëndësisë dhe nivelit të pranisë së segmenteve të kurikulit të fshehtë-joformal (të përmendura më lartë) nga çka njëherit edhe shihet niveli i ndikimit të këtyre segmenteve në realizmin e qëllimeve të kurikulit oficial-formal në shkollën fillore, nëpërmjet testit x² (niveli i lidhshmërisë së përgjigjeve të subjekteve në pyetësorin e ofruar) dhe u konstatua si vijon: Për nivelin e rëndësisë së segmenteve të kurikulit joformal në përditshmërinë shkollore numër më i madh nga tri grupet e subjekteve janë përgjigjur në alternativën, shumë të rëndësishme ndaj alternativave, pjesërisht dhe të parëndësishme. Për nivelin e pranisë së të njëjtave segmente të kurikulit joformal në përditshmërinë shkollore, një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve për shumicën e segmenteve të kurikulit të fshehtë-joformal ishin

përgjigjur se janë pjesërisht të pranishme ndërsa për disa segmente se janë plotësisht të pranishme në përditshmërinë shkollore. Nga analiza statistikore dhe interpretimi teorik i të dhënave të grumbulluara nëpërmjet pyetësorit nga subjektet: arsimtarë, bashkëpunëtorë profesionalë dhe nxënës në shkollat fillore, të zgjedhura me qëllim, për konstatimin e nivelit të rëndësisë dhe nivelit të pranisë së segmenteve të kurikulit të fshehtë-joformal (të përmendura më lartë) nga çka njëherit edhe shihet niveli i ndikimit të këtyre segmenteve në realizimin e qëllimeve të kurikulit ofical-formal në shkollën fillore, nëpërmjet testit x2 (niveli i lidhshmërisë së përgjigjeve të subjekteve në pyetësorin e ofruar) dhe u konstatua si vijon: Për nivelin e rëndësisë së segmenteve të kurikulit joformal në përditshmërinë shkollore numër më i madh nga tri grupet e subjekteve janë përgjigjur në alternativën, shumë të rëndësishme ndaj alternativave, pjesërisht dhe të parëndësishme. Për nivelin e pranisë së të njëjtave segmente të kurikulit joformal në përditshmërinë shkollore, një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve për shumicën e segmenteve të kurikulit të fshehtë-joformal ishin përgjigjur se janë pjesërisht të pranishme ndërsa për disa segmente se janë plotësisht të pranishme në përditshmërinë shkollore.

Nga analiza statistikore dhe interpretimi teorik i të dhënave të grumbulluara nëpërmjet pyetësorit nga subjektet: arsimtarë, bashkëpunëtorë profesional dhe nxënës në shkollat fillore, të zgjedhura me qëllim, për konstatimin e nivelit të rëndësisë dhe nivelit të pranisë së segmenteve të kurikulit të fshehtë-joformal (të përmendura më lartë) nga çka njëherit edhe shihet niveli i ndikimit të këtyre segmenteve në realizimin e qëllimeve të kurikulit ofical-formal në shkollën fillore, nëpërmjet testit x2 (niveli i lidhshmërisë së përgjigjeve të subjekteve në pyetësorin e ofruar) dhe u konstatua si vijon: Për nivelin e rëndësisë së segmenteve të kurikulit joformal në përditshmërinë shkollore numër më i madh nga tri grupet e subjekteve janë përgjigjur në alternativën, shumë të rëndësishme ndaj alternativave, pjesërisht dhe të parëndësishme. Për nivelin e pranisë së të njëjtave segmente të kurikulit joformal në përditshmërinë shkollore, një pjesë e konsiderueshme e përgjigjeve për shumicën e segmenteve të kurikulit të fshehtë-joformal ishin përgjigjur se janë pjesërisht të pranishme ndërsa për disa segmente se janë plotësisht të pranishme në përditshmërinë shkollore.

Conclusion

The school curriculum goals are essential components for the realization of the mission and vision of the school. The achievement of the goals also has an impact on the presence of segments of the hidden-informal curriculum in schools every times. To this end, it is necessary to insist that special attention be paid to the adherence to the segments of informal curriculum which includes a considerable part of the time and activities that the learner has or should take in school abundanc. From the research conducted in primary schools through the survey of the subjects involved in the study it was ascertained that: the level of importance of the informal curriculum segments for achieving the goals of the formal curriculum is very important, while responding to the level of presence of these segments with Influence, in realizing the goals of the formal curriculum, were that they are present in the school everidey.

1. Kentli, F. D. , 2009, COMPARISON OF HIDDEN CURRICULUM THEORIES, Department of Education Science, European Journal of Educational Studies 1-2. University of Hamburg, 20146, Hamburg, Germany, Apple, 1982, p. 3.
2. Probing the hidden curriculum: Teachers' and students' belifes and attitudes, *Paper given at the British Council 18th National Conference for Teachers of English, Palermo, 18-20 March 1999, p.1.*
3. Pavao Brajša, 1995, Sedem skrivnosti uspešne škole, Doba, Maribor, str. 12

References

1. Bajram Selmani. Mësimdhënës i brendshëm në USHT, Fakulteti Filozofik, sektori i Pedagogjisë.
2. Bajram Selmani, 2009, Oddelenskiot rakovoditel kako znaçæen faktor na edukacija, R. pedagogjike, Prosvetno delo nr.2. 2009- Shkup.
3. Bajram Selmani, 2012. Studim rasti “Ora e klasës në funksion të njohjes, formimit dhe zhvillimit të vlerave dhe shprehive edukative”. Konferencë e shoqatës së pedagogëve shqiptarë Tetovë.

4. Bajram Selmani, 2013, Uniteti në veprimin pedagogjik i arsimtarëve në shkollë, Konferenca e shoqatës së pedagogëve shqiptarë në Tetovë 2013.

5. Bajram Selmani, 2013, Kurikuli i fshehtë – joformal, kuptimi roli dhe manifestimi i tij në shkollë në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Nëntor 2013.

6. Bajram Selmani.2014, Rëndësia dhe roli i kurikulimit joformal në mirëvajtjen e procesit të mësimin në shkollë - rendi dhe disiplina si segmente të kurikulimit joformal. Konferenca në Fakultetin Filozofik në Universitetin e Tetovës, Nëntor 2014.

7. Bajram Selmani, 2016, Arsimtari në mes gatishmërisë profesionale dhe objektivitetit në veprim, Revista shkencore pedagogjike, Mësuesi sot nr.2, 2016. NG Grafostil, Saraj.

8. Bajram Selmani, 2016, Ndryshimet në arsim, arsimtari, kurikuli formal dhe kurikuli joformal, Revista shkencore pedagogjike, Mësuesi sot nr.3, 2016. NG Grafostil , Saraj.

9. Kentli, F. D. , 2009, COMPARISON OF HIDDEN CURRICULUM THEORIES, Department of Education Science, European Journal of Educational Studies 1-2, University of Hamburg, 20146, Hamburg, Germany

10. 17. Leskovski, Ilija, 2002, Pedago[ki re~nik, Vekovi[nina, Skopje.

11. Longstreet,W. S. and Shane, H.G, 1993, Curriculum for a neë millenium, Description of the term

Hidden Curriculum Boston: Allyn and Bacon, 26, Boston, London.

12. <http://wik.ed.uiuc.edu/a> Hidden Curriculum, Description of the term Hidden Curriculum, 05:18, 22

July 2008 by Andrew Trost. Based on work by Tony Hursh, Jakob and Craig Johnson and WikEd users Etoney and. Rbritez.

13. Probing the hidden curriculum : Teachers' and students' belifes and attitudes, Paper given at the British

Council 18th National Conference for Teachers of English, Palermo, 18-20 March 1999

14. Pavao Brajša, 1995, Sedem skrivnosti uspešne škole, Doba, Maribor,.

15. Popovski, Kiro, 2000, Programiranje na vospitno-obrazovniot proces, PZ na Makedonija, Skopje.

16. Xheladin M ,Bardhyl M, 2010, Konceptione të kurikulumit, skript për student.

17. *Trebješanin, Ž. , 2008, Rečnik psihologije*, Stubovi kulture, Beograd.

18 . Nenad Suzić , 1998, Kako motivisati učenike, ZZUINS, Srpsko Sarajevo.

1. Nenad Suzić, 2005, Animiranje studenta u univerzitetskoj nastavi, ART i PRINT, Banja Luka.

20. Kyriacou K, 2001, Temeljna nastavna umijća, Eduka, Zagreb, 14 najvaznije zadače nastavnika – Kako organizirati i voditi nastavni.

21. Nenad Suzić, 2006, Cilne orientacije u ponašanje učenika, Pedagoška stvarnost, 7- 8, Novi Sad, Beograd.

22. Nenad Suzić, 1998, Kako motivisati učenike, ZZUINS, Srpsko Sarajevo.